



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.12.2020, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””. (*Komision për dhënie mendimi*)
2. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Klodiana Spahiu, Nikolin Staka, Ralf Gjoni, Fatmir Velaj, Kostaq Papa, Arlind Çaçani, Edlira Hyseni, Musa Ulqini, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Artemis Dralo Malo, Ilir Pendavinji dhe Vasil Sterjovski.

Mungon:

Sadri Abazi

Të ftuar:

Vasilika Vjero – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Zarina Taja –Përgjegjëse Sektori e Drejtorisë së Analizave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar kolegë,

Fillojmë mbledhjen e sotme.

Së pari, do të fillojmë me listëprezencën.

Do t'i thërras emrat një nga një dhe ju thjesht thoni që jeni prezent.

Zonja Mesi? Zoti Velaj? Zoti Ulqini? Zoti Pendavinji? Zoti Balla? Zoti Kamami? Zonja Spahiu? Zonja Kumbaro? Zoti Abazi? Zoti Gjoni? Zoti Staka?

Nikolin Staka – Prezent.

Rudina Hajdari – Zoti Papa? Zonja Hyseni? Zoti Çaçani?

Arlind Çaçani – Prezent.

Rudina Hajdari – Zoti Sterjovski? Zonja Mara? Zonja Jaku? Zonja Dralo?

Dakord.

Fillojmë mbledhjen. Sot kemi për të shqyrtuar projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”. Kjo është e vetmja çështje që kemi në kalendar dhe në rendin e ditës, para se të mbyllim sezonin këtë vit.

Për të prezantuar projektligjin kemi prezentë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë zonjën Vasilika Vjero, zëvendësministre, dhe zonjën Taja, përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Analizave Makroekonomike.

Fillojmë me prezantimin e projektligjit nga zonja Vjero.

Zonja Vjero, fjala është për ju.

Vasilika Vjero – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, ky projektligj vjen si një transpozim i pjesshëm i direktivës nr. 133 së BE-së, e cila përshkruan sistemin e përbashkët tatimor të zbatueshëm për bashkimin, ndarjen, ndarjen e pjesshme, transferimin e aktiveve dhe shkëmbimin e aksioneve midis shoqërive të shteteve të ndryshme anëtare për transferimin e adresës së regjistruar.

Gjithashtu, ky projektligj është edhe pjesë e Planit Kombëtar për Integrimin Europian 2019-2020, sepse është i lidhur ngushtësisht me një prej kapitujve, për të cilët ne raportojmë, që është kapitulli 16 “Tatimet”.

Duke qenë se Shqipëria nuk është ende anëtare e Bashkimit Europian dhe nuk mund të operojë në fushën tatimore me të gjitha rregullat, siç operojnë dhe zhvillojnë aktivitetin bizneset e vendeve anëtare, është parë e arsyeshme që ne të sjellim dhe të propozojmë këtu vetëm një

pjesë të direktivës apo të bëjmë një transpozim të pjesshëm të kësaj direktive. Kjo lidhet kryesisht me shtyrjen e fitimeve të kapitalit për operacionet e bashkimeve, ndarjeve, ndarjeve të pjesshme, transferimet e aktiveve dhe shkëmbimet e aksioneve ose kuotave ndërmjet shoqërive, të cilat janë rezidente shqiptare, dhe këtë do të desha ta theksoja.

Sigurisht, në momentin e aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian ne do të vijojmë më tej, edhe si kërkesë e kapitullit 16, që të vijojmë me transpozimin e direktivës, në mënyrë që të përfshijë edhe ato transaksione që për momentin nuk do të mund të përshkruhen dhe nuk do të mund të jenë pjesë e ndryshimit ligjor që ne po prezantojmë sot.

Ky projektligj, që, në fakt, është parë me shumë kujdes nga ne, është hartuar edhe me asistencën e Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili ka vlerësuar mënyrën se si ne e kemi transpozuar pjesërisht direktivën dhe sa e përshtatshme është ajo për Shqipërinë.

I njëjti vlerësim dhe diskutim është mundësuar edhe me strukturat e Bashkimit Europian, por ne e kemi detyrim që, sa herë prezantojmë një projektligj të ri, do të duhet ta diskutojmë, pra kemi marrë aprovimin edhe prej tyre.

Në fakt, e them këtë, pasi kishim disa diskutime me Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend pak më parë, ku diskutuam komentet bëra prej tyre. Ne kemi rënë dakord për pjesën më të madhe të tyre, ndërkohë për pikën 5 nuk jemi dakord. Ndoshta gjatë mbledhjes së sotme do të kemi mundësi të shprehim opinionin tonë përse e kemi transpozuar... *(nuk dëgjohet.)* dhe pse e kemi gjykuar të tillë dhe përse nuk biem dakord edhe me Shërbimin e Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit.

Ky ishte një përshkrim i shkurtër. Megjithatë, ka edhe përfaqësues teknik që mund të diskutojnë, ndoshta edhe më teknikisht nëse kërkohet, për këtë ndryshim ligjor, i cili prezantohet sot para jush.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Atëherë, siç e dini, si procedurë, do të lejojmë zotin Kasneci të na thotë se si përputhet ky projektligj me direktivat e BE-së dhe nëse është konform tyre.

Do të dëgjojmë zotin Kasneci për pesë pikat që ai ka ngritur me zëvendësministren dhe përse nuk ka rënë dakord për pikën 5, për të vijuar më pas me pyetje nga deputetët dhe përgjigje nga zonja Vjero apo edhe nga zoti Kasneci nëse ne kemi pyetje për të.

Zoti Kasneci, fjala është për ju.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Siç u prezantua edhe nga zëvendësministrja e Financave dhe Ekonomisë, zonja Vjero, projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”,

i ndryshuar” ka qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit European lidhur me sistemin e përbashkët tatimor për operacionet e ristrukturimit ndërkufitar të shoqërive, pra për bashkimin, ndarjen, transferimin e asetëve dhe shkëmbimin e aksioneve, në të cilat dy ose më shumë shoqëri nga shtetet anëtare të BE-së janë të përfshira.

Pra, projektligji është përafuar me atë që quhet *Merger Directive*, pra direktiva e Bashkimit European, e cila si direktivë ka për qëllim heqjen e pengesave fiskale në bashkëpunimet ndërkufitare të kompanive *cross-borders and mergers*, pasi siç e dini, të nderuar deputetë, tatimi direkt është kryesisht fushë e përgjegjësisë së shteteve anëtare (dhe ky është një nga rastet), por BE-ja ka ndërhyrë, pasi mund të ketë raste kur krijohen pengesa, për shembull, taksa që një shtet i vendos një kompanie për të mos u transferuar në një shtet tjetër, e cila bëhet pengesë edhe për realizimin e tregut të brendshëm. Prandaj, BE-ja ka miratuar direktivën *Merger Directive* të vitit 2009/133 “Mbi sistemin e përbashkët tatimor të zbatueshëm për bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjeshme, transferimet e aktiveve dhe shkëmbimet e aksioneve në lidhje me shoqëritë e shteteve të ndryshme anëtare dhe për transferimin e selisë së regjistruar të një SE-je (ose Shoqëri Europiane) ose të një SCE-je (Shoqëri Kooperative Europiane) midis shteteve anëtare.

Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, në mbështetje të veprimtarisë suaj, të nderuar deputetë, ligjvënës të Kuvendit, ka analizuar përputhshmërinë e neneve të projektligjit me nenet që është synuar përfarimi me këtë direktivë dhe për një përafrim më korrekt ka paraqitur në total pesë vërejtje.

Gjithashtu, këto i kemi diskutuar paraprakisht edhe me përfaqësuesit e ministrisë. Nga pesë vërejtje, për tre kemi gjetur dakordësinë e plotë, për një kemi gjetur dakordësinë e pjeshme, ne tërhiqemi nga sugjerimi ynë, kurse për një pikë tjetër, që ne e konsiderojnë të rëndësishme, nuk kemi gjetur dakordësi dhe mbetet në vendimmartjen tuaj.

E nderuar, zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Lidhur me pikën për të cilën nuk kemi rënë dakord mund të shkoj edhe më tej me argumente dhe detaje.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Mund të na thoni në mënyrë të thjeshtë për çfarë nuk keni rënë dakord?

Dedë Kasneci – Zonja kryetare, komenti ynë është ky: në projektligjin e paraqitur nga qeveria është parashikuar situata kur të dyja kompanitë e përfshira në një transaksion janë rezidente në Shqipëri. Nuk ka problem, mund të mbetet edhe siç është, por kjo shkon përtej

fushës së zbatimit dhe objektit të direktivës. Pra, mund të lihet siç është sjellë nga qeveria, por nuk ka lidhje me përafrimin, sepse neni 1 i direktivës, qëllimi, e thotë vetë që në titull: “Kompani, bashkime, ndarje, transferimi i aseteve, shkëmbimi i aksioneve mes kompanive që përfshijnë minimumi dy shtete anëtare”. Pra, situata kur të dyja kompanitë janë rezidente në një shtet të vetëm, anëtar të BE-së, Itali, Francë e të tjera, nuk rregullohet nga legjislacioni i BE-së, shkon përtej direktivës dhe është çështje e rendit të brendshëm ligjor të shteteve përkatëse të BE-së. Pra, me pak fjalë, zonja kryetare, ky është komenti ynë: Shkon përtej objektit të direktivës.

Rudina Hajdari – Zonja Vjero, keni ndonjë koment për këtë?

Vasilika Vjero – Po, do të jetë Zarina që do të bëjë një koment.

Zarina Taja –Përshëndetje!

E nderuar, zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

E falenderoj zotin Kasneci për komentet! Ajo që ai tha është e saktë, por që në fillim të propozimit të këtij projektligji ne kemi qenë të qartë që ky projektligj do të jetë një përafrim dhe transpozim i pjesshëm i direktivës dhe nuk do të aplikohet për transaksionet ndërkufitare ndërmjet shoqërive ndërkombëtare. Kjo pasi në momentin që ndodhet Shqipëria, një shtet jo anëtar, has vështirësi në aplikim. Nëse do të aplikohet edhe për shtetet jashtë Shqipërisë, jo rezidente, do ta kishim të vështirë të ndiqnim momentin e tatimit kur një shoqëri përthithëse është jashtë Shqipërisë, brenda Komisionit Europian, për shembull në Itali.

Në momentin që do t’i lindte tatimi nga fitimi i kapitalit, i realizuar në momentin e përthithjes dhe bashkimit, moment i cili është shtyrë me fitimin kapital të përvetësuar në momentin e tjetërsimit të shoqërisë përthithëse, ne do ta kishim të vështirë të gjurmonim shoqërinë përthithëse. Për këtë qëllim, për të arritur progres në PKIE dhe në përputhje edhe me direktivën në mënyrë të pjesshme vendosëm të propozojmë përafrimin e direktivës vetëm në lidhje me shtyrjen e tatimit të fitimit të kapitalit në një moment të dytë.

Kemi pasur komunikim edhe me ekspertë teknikë të direktivës në Komisionin Europian, siç e tha edhe zonja zëvendësministre, pasi është një detyrim i brendshëm, Ministria e Integritetit ka cituar zyrtarisht që është një direktivë e përputhur në mënyrë të pjesshme dhe prandaj Ministria e Financave dhe Ekonomisë vendosi propozimin e projektligjit në këtë formë, duke qenë të vetëdijshëm që është një përafrim i pjesshëm vetëm për shoqëritë rezidente dhe jo për shoqëritë ndërkombëtare për transaksionet ndërkufitare.

Rudina Hajdari – Zonja Taja, faleminderit për shpjegimin, por duhet të kemi parasysh që momentin që ne si deputetë mbajmë përgjegjëse qeverinë në lidhje me ndryshimet që bëhen

për t'i pasur ligjet tona konform me ligjet e BE-së, ashtu siç na kërkohet në kapitullin 17, që merret me ndryshime fiskale, duhet patjetër që të ketë përgjegjësi një nivel i lartë institucional! Kur flitet për konflikte të tilla, që shkojnë përtej direktivave të BE-së, zonja Vjero, duhet të jepni një shpjegim shterues. Ajo që duhet vënë në dukje është fakti që këto projektligje ndryshohen në emër të direktivave të BE-së, por ndërkohë futet diçka tepër për të justifikuar diçka të njëanshme, që bie në përgjegjësinë e qeverisë dhe ministrisë pse e bën këtë nën ombrellën dhe justifikimin që po e bëjmë konform direktivave të BE-së.

Ndërkohë, direktivat e BE-së nuk kanë nevojë të përputhen, sepse ky projektligj është për një rregullim për shoqëritë fitimprurëse apo shoqëritë që janë të vendosura në Shqipëri dhe nuk kanë fare lidhje me direktivat të BE-së. Pse përdoren rregullat e BE-së, nëse ne nuk kemi nevojë ta ndryshojmë këtë projektligj dhe mund ta ndryshojmë në një moment për ta bërë ashtu siç duhet, por e bëjmë në mënyrë të pjesshme, ndërkohë që shkon edhe përtej direktivave, duke futur një klauzolë që nuk është e nevojshme?

Ajo çka më shqetëson mua është përdorimi i direktivave të BE-së për të fshehur gjëra të tjera brenda projektligjeve, të cilat më pas përdoren nga qeveria për përfitime personale të disa bizneseve apo çka ndodh shpesh shëmtuar në Shqipëri.

Prandaj, zonja Vjero, do të doja të më jepnit një shpjegim më shterues për sa i përket pikës 5, sepse përgjegjësia është juaja dhe jo e zonjës Taja, që përfaqëson patjetër Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por nuk mban përgjegjësi të nivelit të lartë në ministrinë tuaj.

Fjala është për ju.

Vasilika Vjero - Faleminderit, zonja kryetare!

Nga pikëpamja teknike unë nuk kam çfarë të shtoj më shumë nga Zarina, e cila ka punuar ngushtësisht me këtë pikë. Ne jemi përpjekur të sjellim pranë jush sot një transpozim të pjesshëm të direktivës. Duke qenë se nuk jemi vend anëtar i BE-së, ne nuk dalim nga direktiva, nuk po bëjmë asgjë çfarë është jashtë kësaj direktive dhe besoj që edhe shërbimet mund ta shpjegojnë këtë pjesë, thjesht kemi një qasje ndryshe lidhur me pjesëmarrjen apo jo të *cross border*-it, pra të kompanive *cross border* në ndarjen e fitimit, në momentin kur ato bashkëpunojnë, kur bashkohen, kur përthithen me kompanitë shqiptare. Ne nuk jemi kundër asaj direktive, ne kemi thënë vetëm që për sa i takon *cross border*-it marrëdhëniet ndërkufitare që kryhen me kompanitë, që nuk janë rezidente, janë pak të vështira për t'u trajtuar, sidomos kur vjen momenti i ndarjes, i përthithjes, i bashkimit të këtyre kompanive. Pra, administrata tatimore mund ta ketë pak të vështirë për ta evidentuar, por dua të theksoj që këtu nuk ka asnjë përfitim personal të asnjë lloj biznesi apo asnjë prej grupeve të bizneseve, është një kërkesë e Bashkimit Europian.

Ky ndryshim do të jetë pjesë, se ishte parashikuar që të ishte pjesë edhe e ndryshimit në tërësi të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, i cili do të sillet në një moment të arsyeshëm dhe do të prezantohet me grupet aktuale të parlamentit, sikurse prezantohet edhe te grupet e interesit, por edhe në të gjitha komisionet parlamentare. E kemi pasur këtë si një detyrim të KPIE-së, pra 2019-2020 për të ndryshuar këtë aspekt të ligjit. për të përafuar këtë aspekt të direktivës për ta transpozuar dhe prandaj dhe e kemi sjellë sot.

Nuk kam çfarë të shtoj tjetër dhe nga çfarë u shpjegua në nivel teknik. Edhe unë realisht e kuptoj shumë insistimin e përfaqësuesve të Kuvendit lidhur me këtë çështje, për sa kohë ne nuk kemi ndryshuar direktivat, as po e përkthejmë apo po e theksojmë gabim, është një rrethanë që e kemi diskutuar edhe me FMN-në, e kemi diskutuar edhe me strukturat e BE-së, të cilat kanë dhënë konfirmimin që në këtë moment, duke qenë se nuk ka **(Nuk dëgjohet)**...me Bashkimin Europian, nëse duam që kompanive shqiptare t'ju jepet kjo mundësi për transferimin e fitimit, në rastet e bashkimeve, të ndarjeve të përthithjeve, mund ta kryejnë duke e transpozuar direktivën në mënyrë të pjesshme, kur të kemi pastaj pjesë, kur të aderojë në Bashkimin Europian sigurisht direktiva do të transpozohet në mënyrë të plotë, siç mund të ketë ndodhur edhe me direktiva të tjera.

Rudina Hajdari - Zonja Vjero, faleminderit, për përgjigjen, por sërish kam dyshimet e mia dhe me pak durim, ju do më dëgjoni.

E para, një herë, sot është data 22 dhjetor. Dakord? Jemi përpara Krishtlindjeve, datat 24-25, dhe si deputete më bën çudi që unë sot jam e ulur përpara këtij projektligji. Pse ka shumë nxitim ky projektligj përpara festave dhe çfarë na sjell ne këtu sot? Ndërkohë, që shumë qartë ne kemi pasur një përgjigje krejtësisht jo të mirë nga Bashkimi Europian, ku na janë shtyrë negociatat dhe shikojmë që po merreni me një projektligj, i cili siç e thamë dhe e konfirmuat ju, transponon në mënyrë të pjesshme direktivat e BE-së dhe jo vetëm kaq, shkon përtej direktivave, duke futur elemente të tjerë shtesë, ku nuk mundet unë mos dyshoj që ky projektligj, i nxituar në këtë lloj mënyre pa pasur nxitim. S'është fare nevojë të kemi nxitim për të, për të miratuar një projektligj të tillë, pa pasur një arsye tjetër, që nuk del në sipërfaqe dhe pa pasur një arsye që favorizon dikë, në mënyrë që ky projektligj të kalojë kaq shpejt dhe kalimthi, ndërkohë ne nuk e kemi të përafuar ashtu siç duhet 100%, por e kemi të përafuar në mënyrë të pjesshme, siç e thatë edhe ju.

Kjo nuk do shumë mend të arrish në logjikën që ky projektligj vjen në një mënyrë flagrante, duke përdorur kapelën e BE-së, për të nxjerrë një projektligj, sikur çfarë po bëjmë ne, që po i bëjmë ligjet tona ashtu, siç duhet me kërkesë të BE-së, ju thatë: "kërkesë e BE-së", ndërkohë nuk është kërkesë e BE-së, sepse do e kishim marrë vesh nëse do ishte kërkesës e

BE-së urgjente, që ne ta bënim këtë, sepse duhej patjetër. Ky është thjesht një kapitull, si kapitujt e tjerë dhe kemi gjithë kohën.

Më falni, nuk po ju fajësoj ju, por qeverinë tuaj, shefat tuaj, që sot ne nuk kemi mundësinë për të hapur negociatat dhe për t'i bërë këto projektligje, ashtu siç duhet, dhe për t'i përfruar shpejt e shpejt, në mënyrë që të ecim përpara, por falë sjelljes politike, në sajë në fakt edhe dështimeve të qeverisë, ne ende jemi me negociata jo të zyrtarizuara. Ndaj pyetja që kam për ju është: pse keni kaq shumë nxitim kur data është 22 dhe sezoni po mbyllet? Mund ta fillojmë sërish, ta shikojmë avash-avash, të gjykojmë ta bëjmë transpozimin në mënyrë të plotë, mos të bëjmë gabime që s'duhet t'i bëjmë, dhe t'i bëjmë gjërat mirë dhe mbarë, dhe jo kështu shkel e shko dhe kalimthi dhe shpejt e shpejt dhe pa asnjë lloj arsye.

Faleminderit!

Vasilika Vjero - Mund të përgjigjem?

Rudina Hajdari – Po, patjetër.

Vasilika Vjero - Faleminderit, kryetare!

Në fakt, ky projektligj ka qenë pjesë e programit kombëtar dhe është pjesë e programit kombëtar për integrimin 2019-2021, dhe sigurisht ka qenë i parashikuar të miratohej brenda 3-mujorit të fundit të vitit aktual. Pra, unë nuk shikoj që ne po sjellim një legjislacion shumë urgjent, pra po them me prapamendim e të tjera si këto, nuk më takon mua aspak që ta them. Ne jemi brenda programit që është martuara nga qeveria shqiptare. Kemi punuar për të sjellë një projektligj.

Projektligji është diskutuar edhe në Komisionin e Ekonomisë, tashmë po diskutohet edhe para jush. Pra, nga pikëpamja procedurale, nuk kemi përshpejtuar asnjë proces, nuk është as në kushte emergjente, është një projektligj për të cilën është punuar, është edhe pjesë e ligjit i cili është draftuar që në vitin 2015 dhe me asistencën e Fondit Monetar Kombëtar, përsëri Fondi e ka parë, e kanë parë strukturat e BE-së, këtë transpozim të pjesshëm të direktivës. Nuk po bëjmë asnjë lloj ndërhyrjeje në direktivë, nuk është në tagrin tonë, nuk prezantojmë dokumente të tilla. Thjesht është një transpozim i pjesshëm dhe jo plotë i direktivës, sikurse e gjejmë dhe në shumë legjislacione të tjera, ku transpozimet nuk janë të plota, janë të pjesshme për faktin se ne ende nuk aderojmë në Bashkimin Europian. Kur aderojmë në Bashkimin Europian, sigurisht që do të fillojë procesi *streaming* për kapitujt të caktuar dhe do të kemi edhe transpozime të plota të direktivave, për të 32 kapitujt për të cilët ne përgjigjemi. Kështu që, nuk shikoj që të ketë asnjë lloj emergjence, të paktën nga na e qeverisë. Ne vijojmë të qëndrojmë në opinionin tonë, që dokumenti është në përputhje e direktivën dhe në përputhje me strukturat,

të cilat më tej monitorojnë dhe që do t'i vijnë në ndihmë edhe biznesit shqiptar, për transaksione të caktuar që parashikon kjo pjesë e direktivës, pjesërisht.

Rudina Hajdari – Ajo çka më bën çudi, zonja Vjero është që ky projektligj nuk na është komunikuar, nuk ka qenë i parashikuar, nuk ka qenë në kalendarin e punës dhe nuk është marrë asnjë vendim për procedura të përshpejtuara, por ka mbirë nga hiçi. Ky është problemi.

Vasilika Vjero - Ky është pjesë e planit kombëtar për integrim, i cili është vendosur nga qeveria shqiptare.

Rudina Hajdari - Duhet t'jua jap unë fjalën, kështu që mos ndërhyini!

Procedurat parlamentare i dimë, sepse kemi një staf që merret me këtë punë, të cilët e dinë se cili projektligj futet, cili ka procedura të veçanta dhe nuk kanë pse të më keqinformojnë, ashtu siç ndodh shpesh.

Fjala për zoti Gjoni.

Ralf Gjoni - Faleminderit, zonja Vjero!

Në shtjellimin që ju i bëtë projektligjit, që, në fakt, i bashkohem kryetares për faktin se ka ardhur pak papritur, i papërgatitur dhe i paparalajmëruar në kalendarin e punimeve të komisionit dhe seancave, siç edhe seanca e kësaj jave nuk ka qenë e paramiruar për t'u zhvilluar, më vjen çudi që ky ligj, i cili lidhet më një direktivë të Bashkimit Europian, vjen pikërisht në datën 22 dhjetor, ju thatë që këtë e ka kërkuar BE-ja. Cila BE jua ka kërkuar? Kur jua ka kërkuar? Pse jua ka kërkuar? Sepse, në atë vite sa e njoh unë BE-në, edhe vetë vendet anëtare të BE-së nuk bëjnë çdo gjë që u kërkon BE-ja, përkundrazi, lufta brenda BE-së është jashtëzakonisht e madhe për t'u dhënë formë direktivave të BE-së apo mënyrës sesi këto direktiva aplikohen, duke pasur parasysh edhe mënyrën sesi shpeshherë direktivat e BE-së ndërhyjnë dhe prishin punë në legjislacionin, por edhe në interesat kombëtare të brendshme të vendeve anëtare. Kështu që ne nuk kemi pse të tregohemi të mbizellshëm për t'u sjellë si vende anëtare të BE-së, kur BE-ja (këtu përfitoj nga rasti të korrigjoj kryetaren, me lejen e saj) nuk është se i shtyu negociatat, por nuk donte të merrej me hapjen e negociatave apo me fillimin e Konferencës Ndërqeveritare. Pra, në momentin që një union ka hallet e veta dhe nuk do t'ia dijë për ne, për zellin e madh dhe këtë dashuri të madhe për një familje, e cila nuk na dëshiron të jemi pjesë e saj për momentin... Thjesht dua të di, kush jua ka kërkuar nga BE-ja, sepse unë kam ndër mend ta ndjek këtë çështje, qoftë delegacionit të BE-së, qoftë Brukselit, stafit të komisionit, për të ditur se ku është interesi që BE-ja kërkon një përafrim të pjesshëm të direktivave të saj në datën 22 dhjetor, ndërkohë që ata vetë nuk janë të gatshëm të fillojnë konferencën ndërqeveritare?

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Zonja Vjero a keni një përgjigje apo koment?

Vasilika Vjero - Po, unë dua të citoj edhe një herë që ky projektligj është pjesë e programit kombëtar për integrim, i miratuar në vitin 2019 nga qeveria shqiptare, dhe i përket harkut kohor 2019-2020. Pra, është parashikuar që për kapitullin XVI, i cili përfshin tatimet, në këtë hark kohor 2-vjeçar apo 3-vjeçar të mund të miratohen një sërë ligjesh, të cilat janë të lidhura me përafrimin e direktivës. Përafrimi i direktivës bëhet pas një pune të madhe të ekspertëve, ku shikohet nëse një direktivë e BE-së do të përafrohet pjesërisht, në mënyrë të plotë, apo nuk mund të përafrohet, pasi do të duhet që të jemi pjesë e BE-së, në mënyrë që ajo të përafrohet e plotë.

Nga vlerësimi që i është bërë direktivës është parë që me këtë ndryshim që ne sjellim sot e përafrojmë atë në mënyrë të pjesshme. Ne e kemi parashikuar në planin kombëtar të integritit, kemi raportuar dhe raportojmë pranë negociatorit dhe pranë BE-së lidhur me ecurinë e këtij plani, të akteve dhe direktivave, të cilat transpozohen kur duhet të miratohen ligje apo akte nënligjore. Kjo është e gjithë procedura që kemi ndjekur.

Dokumenti i këtij ligji është miratuar në fillim të muajit dhjetor nga Këshilli i Ministrave, më tej i është përcjellë parlamentit për t'u diskutuar, por ju siguroj që është pjesë e planit të integritit, i cili çdo vit diskutohet për 32 kapitujt dhe më tej miratohet. Ky plan përfshin të gjitha aktet ligjore, që duhet të miratohen për një periudhë 3-vjeçare. Njëkohësisht, dua t'ju them që ky transpozim dhe ky propozim që kemi sjellë sot është diskutuar edhe me strukturat e BE-së. Ne e kemi si kërkesë që çdolloj akti përafrohet, i cili hartohet, duhet të diskutohet me strukturat e Bashkimit Europian. Pra, duhet të japin komentet dhe sugjerimet e tyre për mënyrën sesi direktiva po materializohet në një legjislacion të caktuar. Kjo është bërë, ne i kemi të gjitha komunikimet dhe mund t'ua vëmë edhe juve në dispozicion në rast se e gjykoni që duhet të merrni pjesë apo të shikoni si ka qenë edhe reagimi i tyre.

Rudina Hajdari - Zonja Vjero, e dëgjova me vëmendje komentin tuaj dhe jemi në dijeni që ka një plan kombëtar për integrimin europian, i cili duhet të gjejë zbatueshmëri në kohë dhe ne duhet të plotësojmë objektivat tona, në mënyrë që të përmbushim të gjithë kapitujt që kërkon BE-ja në lidhje me legjislacionin tonë. Ju thatë që keni pasur kërkesë nga BE-ja në lidhje me këtë projektligj dhe ne duam të na e dërgoni këtë kërkesë specifike që BE-ja ju ka bërë, sepse nëse është e nevojshme për ta bërë këtë ndryshim, ndoshta dyshoj nga skepticizmi, dyshoj që kërkesa të jetë në këtë formë dhe në këtë mënyrë.

Unë nuk do të doja që t'i rikthehem projektligjit edhe një herë tjetër, duke e ndryshuar dhe duke e bërë një projektligj të pjesshëm dhe të pazbatueshëm, ose të keqmenaxhueshëm

për mënyrën sesi mund të aplikohet nesër, ndaj, për ta bërë më të besueshëm procesin dua që të më dërgoni këtë komunikim që keni pasur nga BE-ja në lidhje me këtë kërkesë.

Ralf Gjoni - Zonja Kryetare, më fal, se nuk mora përgjigje!

Rudina Hajdari – Pasi të mbarojë zonja Mesi, mund të flisni ju, zoti Gjoni. Më pas sqarohuni më zonjën Vjero.

Fjalën e ka zonja Mesi.

Senida Mesi – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, e mora fjalën për dy arsye:

Një për një lloj dezinformimin që po kërkohet të bëhet këtu në komision.

Zoti Gjoni më duket shumë skeptik jo vetëm në rastin konkret, por ka ditë dhe muaj që tregon një lloj skepticizmi, të cilin e mirëkuptoj në momentin që negociatat vazhdojnë në një ritëm, por jo ashtu sikurse kemi dëshirë ne.

Së dyti, lidhet me dezinformimin, zonja kryetare, negociatat janë hapur, është shtyrë Konferenca e parë Ndërqeveritare, duhet të plotësojmë disa kushte. Sikurse u përmend edhe nga kolegët e këtij komisioni, a është gati Europa apo a ka në qendër të vëmendjes pjesën e bërjes së Konferencës së parë Ndërqeveritare, pra të zgjerimit qoftë me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut, kjo është një çështje krejt tjetër nga ajo që po diskutojmë këtu. Ajo që po diskutojmë këtu është një diçka që me vendim të Këshillit të Ministrave ne kemi një plan kombëtar në lidhje me të gjithë ecurinë për integrimin dhe cilat janë ato transpozime dhe direktiva, të cilat duhet t'i marrim parasysht për t'i kaluar brenda një sezoni të përcaktuar në Kuvendin e Shqipërisë. Besoj se bini dakord me mua që deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht datave dhe festave, punojnë 365 ditë të vitit. Kemi e jemi në punë deri në datën 24 dhe më pas fillon puna përsëri dhe, si rezultat nuk më bën fare përshtypje nëse vjen më 22, 23 apo 24 një projektligj i caktuar.

Për informacionin tuaj, ne e kemi trajtuar javën e kaluar, sepse jam anëtare e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, të njëjtin projektligj në Komisionin e Ekonomisë, për sa kohë që flet edhe për tatimet.

Në lidhje se çfarë po bëjmë ne me transpozimet, dhe këtu besoj se kam plot dëshmitarë nga ana profesionale teknike dhe nga Departamenti i Përafrimit të Legjislacionit të Kuvendit me *acquis*, ne po transpozojmë, në bazë edhe të planit të aprovuar me vendim të Këshillit të Ministrave të Planit Kombëtar për Integrimin, një seri ligjesh të cilat prekin kapituj të rëndësishëm.

Sot për sot shumica nga këto transpozime që po bëjmë, nuk janë detyrim në kushtet dhe në fazën e procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Megjithatë, unë gjej rastin këtu të përgëzoj të gjithë Këshillin e Ministrave dhe të gjithë ekspertët që po punojnë me ta në lidhje me të gjitha ligjet që na vijnë këtu në këtë komision të nderuar për trajtim dhe për transpozim. Kur flas transpozim, sigurisht, direktivat ose përkthen dhe transpozohen 100%, nëse ne jemi gati, por, po të ishim gati, ne do të ishim anëtarë të plotë, me të drejta të plota të Bashkimit Europian. Kështu që unë gjej rastin këtu të them, që po transpozohen me aq mundësi sa ekzekutivi ka për të përmbushur detyrimet ligjore. Po transpozohen me aq mundësi sa ka kuadri legjislativ në përgjithësi në Republikën e Shqipërisë, dhe këtu nuk gjykoj se ka asgjë të keqe, përkundrazi, është një aparat i tërë në ministrinë përkatëse bashkë me ekspertë të Bashkimit Europian apo ekspertë të tjerë të jashtëm që po punojnë në lidhje me transpozimin e direktivave të ndryshme, duke gjykuar dhe vlerësuar çfarë mund të bëhet tani, edhe pse nuk është detyrim i Shqipërisë në lidhje me çështjen e integritit europian dhe çfarë nuk mundet. Unë e vlerësoj punën dhe atë që tha zëvendësministria, kur deklaroi: “Po, e dimë që 1, 2, 3 nene dhe kapituj nuk mund të ndryshohen dot, sepse ne nuk jemi gati”. Kjo vlen për t’u përgëzuar. Meqenëse sot nuk jemi gati, vjen kërkesa ime ndaj ministrisë përkatëse se çfarë duhet të bëjnë ata dhe për çfarë duhet të vihemi edhe ne në dijeni, me qëllim që t’i monitorojmë. Pra, çfarë duhet të bëjnë ato gati, me qëllim që në momentin kur do të duhet kjo direktivë të jetë gati, në rastin konkret flasim për kapitullin XVI dhe për tatimet. Qeveria shqiptare kur t’i vijë koha, pavarësisht se cili qeveris në atë moment, duhet të jetë gati, me qëllim që në momentin kur do të jemi anëtarë dhe bëhen konferencat e para ndërqeveritare apo aprovohet plani negociator dhe krejt kuadri i negociatave, ne të jemi aty ku duhet dhe të mos themi pas 2, 3, 4 apo 5 vjetëve: “Jo po që më 22 dhjetor të vitit 2020 ne e dinim që ishte ky problem dhe nuk morëm masat e duhura”.

Në lidhje me përafrimin, me sa mora vesh, palët kanë rënë dakord, me përjashtim të një ndryshimi, ku vetë zoti Kasneci tha që tërhiqet dhe bien dakord. Kështu që unë e gjykoj pozitivisht të gjithë procesin, pavarësisht nga njoftimi, ndoshta i vonuar, i Komisioni i Integritit Europian. Ju thashë dhe e përsëris që ne kemi kaluar te Komisioni i Ekonomisë një projektligj të ri dhe, zonja kryetare, ju jeni pjesë e Konferencës së Kryetarëve dhe e dini shumë mirë që nuk kalon asnjë projektligj në komisione pa një vendimmarrje në Konferencën e Kryetarëve dhe pa një njoftim nga Kryetari i Kuvendit. Se ku është problemi në rastin konkret, ndoshta, bashkë me sekretariatit dhe me pjesën e stafit të Kuvendit do ta investigojmë, sepse na është dashur ta kishim si informacion që javën e kaluar.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Fjalën e ka zoti Gjoni.

Ju lutem, pak shkurt, zoti Gjoni, meqenëse është hera e dytë që po flisni, pra nëse keni të njëjtën pikë, mos e ripërsërisni veten, duke harxhuar kohën.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Thjesht insistova, sepse nuk mora përgjigje. Bëra vetëm një pyetje dhe nuk mora asnjë përgjigje. Bëra një pyetje specifike: cili person, cila zyrë dikaster nga Bashkimi Europian, qoftë në Bruksel, qoftë në delegacionin e Bashkimit Europian në Tiranë i ka kërkuar qeverisë shqiptare që kjo të miratohet brenda dhjetorit me një seancë të çuditshme, si kjo e sotmja?

Zonja kryetare, u kujtoj të gjithë kolegëve që Komisioni Integritetit lidhet vetëm me një objekt: për të shqyrtuar këtë projektligj, i cili, në fakt, flet për bashkim dhe përthithje shoqërishe. Mua më duket e çuditshme që në datën 22 dhjetor në një seancë të paplanifikuar një komision i nderuar parlamentar mbledhet vetëm për të folur për bashkime dhe përthithjet e shoqërive. Më duket e çuditshme. Ky projektligj është jashtëzakonisht specifik për të qenë thjesht pjesë e një plani të përgjithshme të integritetit europian, siç thotë edhe zonja Vjero. Për mua mban erë dhe meriton vëmendje për t'u parë më thellë. Pse zonja Vjero nuk i vini një emër? Mua më tingëllon sikur ky projektligj është një qokë që i bëhet ndonjë oligarku të caktuar, i cili ka ndonjë interes deri në fund të vitit. Vërinë emrin këtij oligarku ligjit, mos i vini emrin e integritetit europian.

Shumë shkurt, falënderoj nënkryetaren Mesi që më kujton euroskepticizmin tim, i cili, në fakt, nuk është aspak euroskepticizëm, është thjesht si ajo puna e dashurisë dhe e acarimit brenda një familjeje, zonja Mesi, dhe për momentin, unë jam shumë i acaruar dhe nuk më vjen “marre”, siç i thoni ju nga Shkodra, apo turp të na e thonë hapur këtë gjë, sepse me miqtë tanë europianë, nëse janë partnerë, duhet flasim hapur, siç ata flasin hapur me ne, por ata, fatkeqësisht, po e trajtojnë integritetin europian për vendet e Ballkanit tamam si puna e një balone, e ngrenë në ajër, ta tregojnë sa e bukur që është dhe çdo muaj lëshojnë nga pak pe dhe balona çdo muaj e çdo vit largohet gjithnjë e më tepër. Unë nuk jam nga ata proeuropianistë që dëshirojnë që integriteti europian të mbetet një fabul në raportet e disa burokratëve, që marrin ca rroga marramendëse në Bashkimin Europian dhe nuk bëjnë asgjë tjetër veçse shkruajnë dhe miratojnë raporte.

Unë nga, zonja Vjero dua të di: cili dikaster, cili person i ka kërkuar qeverisë shqiptare? Mos më thoni që keni një plan të integritetit europian nga 2019, se ky është tmerrësisht specifik si projektligj dhe është shumë i pjesshëm për t'u kaluar në datën 22 dhjetor, para Krishtlindjeve, në kohë pandemie, thjesht nën siglën e integritetit europian. Po pres një përgjigje zonja Vjero.

Faleminderit, kryetare!

Rudina Hajdari – Po, zonja Vjero, fjala për ju, ju lutem, sa më shkurt.

Vasilika Vjero – Atëherë, unë, zoti Gjoni, do të doja të përsërisja edhe një fjalë që ne kemi 32 kapituj dhe të gjithë këto kapituj janë të lidhur me fusha specifike dhe lidhen me direktivat e Bashkimit Europian, është bërë transpozimi i direktivave për të gjithë këto kapituj, por unë do të merrem me kapitullin 16, që është ai e tatimeve dhe nga transpozimi i detyrave të Bashkimit Europian kanë dalë një sërë legjislacionesh, të cilat do të duhet që të taten nga qeveria shqiptare për një periudhë disavjeçare. Pikërisht hartimi i këtyre legjislacioneve, të cilat ose e transpozojnë direktivën të plotë, ose të pjesëshme, më tej, pasi janë hartuar dhe vlerësuar nga ekspertët, propozohen për t'u miratuar në një hark të caktuar kohor. Ky ndryshim vjen është propozuar nga Ministria e Financave, që të miratohet në periudhën 2019 – 2020. Ka qenë miratuar në planin kombëtar për integrimin europian, i cili është i publikuar dhe mund të verifikohet nga kushdo. Madje ka qenë i parashikuar të miratohej nga Ministria e Financave në 3-mujorin e fundit të vitit 2020.

Nuk kam se çfarë të ju them më tepër, ky është një proces, i cili ndiqet nga të gjitha ministrinë, është një proces shumë i hapur për të gjithë kapitujt, për të cilët ne do të duhet të përafrojmë legjislacionin. Më tej përafrimi i legjislacionit shoqërohet edhe me proceset *screening*, për të cilat edhe ju jeni shumë të vetëdijshëm për këtë gjë. Nuk ka lidhje me asnjë prapamendim, është një projektligj, i cili vjen në ndihmë të kompanive shqiptare në momentin kur ato përthithen apo bashkohen me njëra-tjetrën, në mënyrë që këtë fitim të mos ta paguajnë në atë moment, por ta paguajnë në momentin kur kjo kompani do të shitet ose do të transferohen aksionet. Kjo është kërkesa e direktivës, nuk po bëjmë asgjë më shumë, asgjë më pak se sa kërkesa e direktivës, këtë thotë dhe direktiva e Bashkimit Europian, ku dhe ne dëshirojmë që të jemi pjesë shumë shpejt.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Vjero!

Besoj se e ezauroam këtë pjesë, sepse po zgjatemi e po përsërisim të njëjtat gjëra. Ajo çka kërkuam është që, ndoshta meqë keni pasur komunikim me delegacionin e Bashkimit Europian ose nëse keni pasur komunikime të tjera, në Bruksel në lidhje me këtë pikë, ju lutem, të na e vendosni në dispozicion, në mënyrë që të shikojmë që kjo ka qenë një kërkesë e tyre dhe ta vërtetojmë në këtë mënyrë dhe do t'ua çojmë të gjithë deputetëve, por, pavarësisht kësaj, unë ende kam dyshimet e mia.

Ju ftoj ta votojmë tani, ta kalojmë këtë projektligj në votim. Ne jemi pa dyshim komision për dhënie mendimi dhe ana teknike bëhet nga një tjetër komision por ajo çka është e rëndësishme është që ne të kujdesemi për ato direktiva, të cilat duhet të bëjmë të pamundurën

që t'i përputhim në mënyrë të plotë dhe të jemi konform me të gjitha udhëzimet dhe kërkesat që kemi nga Bashkimi Europian, në mënyrë që të kemi një proces sa më të shpejtë e sa më të mirë.

Kalojmë në votimin e projektligjit në parim, pastaj do ta kalojmë në votimin nen për nen, me të gjitha ndryshimet që zoti Kasneci ka rënë dakord. Do të votojmë atë nen që zoti Kasneci nuk ka rënë dakord dhe do të shikojmë sesi do të votohet.

Atëherë, kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, siç e thashë, do të kalojmë në votimin nen për nen, por me ndryshimet që kanë rënë dakord, pra me katër pikat që kanë rënë dakord, duke lënë jashtë nenin 3, pika 3.

Kush është dakord me ndryshimet që ka bërë zoti Kasneci dhe ka rënë dakord me zëvendësministren në lidhje me këtë projektligj? Kundër? Abstenim?

Do të hedhim në votim nenin 3, pika 3, pra pikën 5 të zotit Kasneci, që bie në kundërshtim me nenin 3, pika 3 dhe zoti Kasneci e ka cilësuar në pikën 5 të tij me arsyetimin e tij në lidhje me këtë pikë dhe se si duhet të riformulohet, ai sugjeron që ky nen duhet të riformulohet si vijon:

“Ky nen zbatohet për transaksionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni vetëm nëse shoqëria transferuese ose shoqëria përthithëse është rezidente në Shqipëri”, ky është korrektimi që ka bërë zoti Kasneci. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Atëherë, kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim?

Faleminderit, projektligji miratohet me 2 kundër dhe asnjë abstenim.

Faleminderit, zonja Vjero, për praninë tuaj, falënderoj edhe kolegët për praninë e tyre sot dhe shihemi nesër në seancë!

Ju uroj një ditë të mbarë!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA